



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	07.06.2025
Referencë	11-344/6
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-qershor

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit qershor Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- gjatë muajit qershor në fokus kishin inspektimin e lokaleve afariste. Janë realizuar urdhëresa për regjistrim të lokaleve dhe urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste. Në bazë të kërkesave të bizneseve janë realizuar pranime teknik të lokaleve afariste për të ushtruar aktivitetin e tyre biznesor dhe janë pajisur me Aktvendim.

Kontrollim i vazhdueshëm i tregjeve, në tregun e gjelbër janë urdhëruar të gjithë tregtarët të cilët kanë qenë jashtë hapësirës së tregut, ty hynë në hapësirat e tregut, si dhe tregu i mobileve dhe ai i kafshëve janë inspektuar.

Inspektorët e trafikut- Inspektimi për firma të autobusëve është bërë në lidhje me licenca, certifikata të autobusëve dhe për rende të udhëtimit se a janë të pajisur si dhe a janë duke e respektuar rendin e udhëtimit ku disa prej tyre i kemi dhënë vërejtje që të respektohet në vazhdimësi, ndërsa për radio-taks..

Janë organizuar kujdestari ku gjatë kujdestarisë në Aeroportin Ndërkombëtarë “Adem Jahri” ku në fokus ishin auto-taxit të cilët tentojnë të operojnë ilegalisht, si dhe radio taksit.

Inspektim të gurthyesit në Plitkoviç ku është dhënë një urdhëresë për rregullimin e rrugës e cila është dëmtuar gjatë punimeve të gurthyesit.

Inspektori i ndërtimit- Përgjatë muajit qershor inspektori i ndërtimtarisë ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në teren, e sidomos përgjatë zonës urbanistike, industriale, ekonomike. Me procesverbal është evidentua dhe konstatuar për të gjitha ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi. Ndaj ndërtimeve pa leje janë ndërmarrë masa ligjore, duke vendosur edhe shirita zyrtar.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët në formë të shkruar, elektronike apo përmes telefonatës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit qershor janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike të lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Gjoba mandatore.

Aktvendime.

Kallëzim penal

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Kallëzim penal	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	168	25	11						72	12				175€	8	9	17			14
Ambienti																				
Ndërtimi	57	15		1	14		1		4	18	1		2					1		
Trafiku	54	13						18	8							11			4	
Gjithsej	279	53	11	1	14		1	18	84	30	1		2	175€	8	20	17	1	4	14

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.